

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Gyltene Sylejmani dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit N.P.T “N.” me seli në ... të cilën me autorizim e përfaqëson ICS Assistance L.L.C, avokat B. N., kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.”, me seli në Prishtinë, për shkak të shpërblimit të dëmit material, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.142/2017 datë 2.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 6.4.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.142/2017 datë 2.10.2019.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.142/2017 datë 2.10.2019, është refuzuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, III EK.196/13 datë 24.4.2017, me të cilën nën pikën I dhe II të dispozitivit është aprovuar kërkesëpapia e paditësit N.P.T “N.” me seli në ..., ashtu që është detyruar e paditura Kompania e Sigurimeve “E.” me seli në Prishtinë, që t’ia paguaj paditësit shumën prej 135.311,33 €, në emër të shpërblimit të dëmit , me kamatë ligjore 8% duke fillura nga data 3.1.2013, deri në pagesën definitive , të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. Në pikën III të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 6.556,75 € në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet revizioni dhe të prishen që të dy aktgjyqimet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në përgjigje në revizion, paditësi ka propozuar që revizioni e të paditurës të refuzohet

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjyqimit të goditur, sipas nenit 215 e lidhur me nenin 505 të LPK, gjeti se:

Revizioni është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pran gjykatës së shkallës së parë dhe në bazë të provave të administruara është vërtetuar se paditësi me të paditurën kanë lidhur kontratë të sigurimit të pronës nga zjarri dhe rreziqet shtesë me nr.të policës ..., e datës 13.8.2013, me period të zgjatës prej 14.8.2012 e deri më 13.8.2014, të cilën kontratë kanë nënshkruar palët ndërgjyqëse, ku njëherit janë përcaktuar drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese si dhe lartësia mbulesës së rreziqeve të sigurimit .Objekti i kontratës së sigurimit kanë qenë ndërtesa në shumën prej 150.000,00 €, mallrat në shumën prej 300.000,00 € dhe enterieri, pajisjet biznisore në shumën prej 120.000,00 €. Paditësi për sigurimin në bazë të kontratës në fjalë ka paguar premittë e sigurimit.

Me datën 20.12.2012 reth orës 19:30 ,në objektin e paditësit është shkaktuar zjarri i cili ka dëmtuar obkjektin, stabilimentet e makinerisë si dhe mallrat me vlerë prej 135.311,33 €. Me kërkesë të paditësit me datën 21.12.2012 , ka dal në vendë të ngjarjës ekipi e të paditurës e cila pas 3 ditë të inspektimit lejon paditësin që të pastroj terrenin ,paditësi ka bërë kërkesë të paditurës të shpërblej dëmin në bazë të policës së siguirmit të cilën e paditura me vendimin e saj nr 01\2013 të datës 2.4.2013 refuzon kërkesën e paditësit me arsyetim nuk mbulohet me policë të sigurimit ,nga se dëmi është shkaktuar me dashje apo nga pakujdesia e rëndë të paditësit dhe anëtarve të familjës së padisit. Sektori i Mbrotjës Preventive nga Zarri Komunës së Mitrovicës , ka konstatuar se me datën 20.12.2012 në ora 19:28 ka shpërthyer zjarri në objektin e paditësit, ku është djegur instalimi i rrymës, makinat dhe mallrat e ndryshme Ndërsa Agjencia për menaxhimin e emergjencave të MPB Republikës së Kosovës, na raportin e saj nr 180 të datës 27.12.2012, ka konstatuar se në objektin e paditësit instalimi elektrik ka qenë me harmoni me normat teknike me siguresat automatike me kontaktorin FID si dhe ndërprerësin manual. Një

herit në këtë raport konstatohet se shkaktar i zjarrit është donjë veprim I papargjegjshëm dhe se dyshohet se është lënë donjë lëndë ndezëse prej nga zjarri është përhapur mew ç,rastë është djegur objekti, makineria dhe mallrat e paditësit.

Në raportin e tij të datës 26.1.2015 si dhe në raportin plotësues të datës 18.11.2016 si dhe gjatë shqyrtimit kryesor eksperti i einxhnerisë elektrike R. S., ,ka konstatuar është i pranueshëm konstatimi i dhënë nga ekspertiza e dhën prokurorisë lidhur me atë se shkaku i zjarrit e ka burimin në instalimet elektrike nga shfrytëzimi tyre në punë normale përkatësisht zjarri është shkaktuar nga lidhja e shkurtër në instalimet elektirke. Sipas mendimit të këtij eksperti dhën shqyrtimin kryesor lidhur me atë mungesa e sistemit automatik për mbrotje nga zjarri a ka mundur të jetë shkaktar i zjarrit i njëjti ka daklluar se mungesa e sistemit automatik nuk mundur të jetë shkaktar i zjarrit edhe pse kanë munguar.

Eksperti i mbrotjës nga zjarret H. H. inxhimer mbrotjës nga zjarri ,në mendimin e tij dhënë lidhur me shkaktarin e zjarrit konstaton se deri te zjarri ka ardhur në mungesë të instalimit të sistemit automatik për mbrotje nga zjarri dhe se ekziston përgjegjësia e ndarë për dëmin e shkaktuar.

Nga mendimet dhe konstatimet ekspertëve A. G. ekspert financiar, N. M., eksperti i ndërtimtarisë dhe S. B., ekspert i makinerisë dhën me datën 8.2.2017, kanë vlerësuar dëmin te paditësja e cila kap shumën prej 135.311/33 € e cila përfshinë dëmin në objekt në shumën prej 16.733,00 €,dëmi në stabilimente dhe makineri në shumën prej 13.140,00 €,dëmi në mallra në shumën prej 102.733,33 €, si dhe për asgjësimin të të mallit të dëmtuar në shumën prej 1.500,00 €

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe ka detyruar të paditurën që në emër të dëmit të përgjithshëm të paguaj paditësit në bazë policës së sigurimit nga zjarri shumën prej 135.311,33 € duke u referuar neneve 918,919 paragrafi 1 dhe nenit 950 Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e vendosjes sipas ankesës e të paditurës, të njëjtën e ka refuzuar dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë duke pranuar në tërësi konstatimet faktike dhe vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke pranuar në tërësi qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, ka vlerësuar si të drejtë mendimin e gjykatës së shkallës së dytë e cila është e bazuar në të drejtën materiale kur ka refuzuar ankesën e të paditurës.

Nga gjendja e vërtetuar faktike është vërtetuar fakti se zjarri në objektet e paditësit është shkaktuar në instalimet elektrike, nga shfrytëzimi i tyre normal ,përkatësisht nga lidhja e shkurtër në instalimet elektrike të paditësit i cili ka qenë legalisht i kyçur në rrjetin elektrik. Mungesa e sistemit automatik për mbrojtje nga zjarri .nuk ka mundur të jetë shkaktar i zjarrit edhe pse instalimet lajmëruese dhe mbretje nga zjarri nuk kanë ekzistuar. Kjo eliminon çdo bazë të përgjegjësisë së paditësit ,pasi që dëmi i shkaktuar paditësit nga zjarri për shkak lidhjes së shkurtër në instalimet elektrike dhe njëjta mbulon rastin e siguruar sipas policës së sigurimit në mesë të paditësit dhe të paditurit , me të cilën paditësi ka siguruar rreziqet themelore nga zjarri, rrufeja ,eksplozioni dhe rënia e aeroplanit dhe pjesë tyre, për ndërtesën , enterierin ,pajisjet fikse dhe pajisjet biznisore.

Në bazë të nenit 918 Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve(Nr.04\L-077) përcaktohet: *‘‘Me kontratën për sigurimin detyrohet kontraktuesi i sigurimit që mbi parimet e reciprocitetit dhe solidaritetit të paguajë një shumë të caktuar shoqërisë së sigurimit (siguruesi), kurse shoqëria detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që paraqet rastin e siguruar, t’i paguajë siguruesit apo ndonjë personi të tretë shpërblimin, përkatësisht shumën e kontraktuar ose të kryejë diçka tjetër’’*.Paditësi ka paguar premin e sigurimit dhe se paditura detyrohet që paditësit t’ia paguaj shpërblimin për demin e shkaktuar nga rasti siguruar në bazë të kontratës së sigurimit në bazë të nenit 940 par 1 të LMD

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se aktgjykimi i goditur përmban shkelje nga neni 182.2 par. 2 pika (n) nga arsyeja se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar të gjitha nr 04pretendimet e dhëna në ankesë, duke dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse, të cilat janë të pranuar nga gjykata e revizionit.

Nuk qëndrojnë thëniet e revizionit se vendimi i gjykatave të instancës ma të ulët bazohen në raportin e ekspertit të elektros i cili nuk është thirur për të vëretuar shkaqet e zjarrit , sepse eksperti është thirur vetëm për çështje elektrike dhe se në raportin e e Agjencisë e Manaxhimit të Emergjencave dyshohet se gjerë te shkaktimi i zjarrit ka ardhur nga donjë mjet ,lëndë ndezës , nuk qëndrojnë nga fakti për shkakun e shkaktimit të zjarrit është i thirur eksperti elektros i cili raportin e ka bazuar në provat dhe dokumentacionin të cilat janë në shkresat e lëndës , i cili në raportin e tij si dhe nga raporti i ekspertit A. N., ,dhënë në prokurori është konstatuar se zjarri në objektin e paditësit është shkaktuar nga lidhja e shkurtër e paraqitur e cila ka mjaftuar që shkëndija të ndezë zjarrin në tekstil, të cilat janë përfshirë shpejtë nga flaka dhe ardhur deri te dëmi në objektin e paditësit .Ndërsa sa i përket raportit të Agjencisë e

Manaxhimit të Emergjencave se shkaktari i zjarrit është se është hedhur donjë mjet djegëse ,kjo ka qenë vetëm dyshim fillestar e cila më vonë është sqaruar nga eksperti i Mbrojtës nga zjarri H. H., sa i përket këtij dyshimi është deklaruar se për” ...” është një term i panjohur, ashtu si është konstatuar në raportin Agjencisë e Manaxhimit të Emergjencave.

Ligji për marrëdhëniet e Detyrimeve (Nr.04\L-077) e cila është shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me 19.5.2012 ,në bazë dispozitës së nenit Neni 1059 ky ligj hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës,nga kjo del se ky ligj ka qenë në fuqi në kohën kur është shkatuar zjarri si rast I siguruar dhe ka qenë në fuqi LMD nr 04\L-077,prandaj thëniet e revizionit se ky ligj nuk ka qenë në e aplikueshme nuk qëndron. Në rastin konkret vjen në shprehje llogaritja e kamatëvonesës në bazë të nenit 382 LMD pasi që detyrimi e të paditurës ndaj paditësit në kohë kur ka qenë në fuqi të këtij ligji dhe se thëniet e revizionit se kamatëvonesa është dashtë të llogaritet siap LMD I RSFJ e vitit 1978.

Se ndaj ekspertit A. J N., është paraqitur kallëzim penal, nuk ka ndikim në vendosje në këtë çështje juridike , pasi që vendimi i gjykatave të instances ma të ulët nuk bazohen në mendimin e këtij eksperti por mendimi e këtij ekspertii ka qenë njeri nga provat të administruara në vendosje të kësaj çështje juridike,prandaj thëniet e revizionit të paditurës në këtë drejtim janë të pabazuar dhe se me asnjë dispoziti të Ligjit të Procedurës kontestimore si shkak për paraqitjen e revizionit ekzistimi i veprës penale.

Thëniet tjera të revizionit që kanë të bëjnë me gjendjen faktike, gjykata nuk i ka vlerësuar, pasi që revizioni për këtë shkak nuk mund të paraqitet..

Nga arsyet e dhëna më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 222 lidhur me nenin 505.1 të LPK-së.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

E.Rev.nr.1/2020 datë 6,prill 2020

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri